



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 751 Akti

Nr. 620 Vendimi
Tiranë, më 6.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 6.2.2023, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Flamur Kolleshi**, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Flamur Kolleshi ka qenë subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Me shortin e datës 15.6.2021, ai është shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Xhensila Pine (relatore). Menjëherë me hedhjen e shortit trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit dhe caktoi kryesues komisionerin Roland Ilia.

3. Komisioni, gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, u vu në dijeni se subjekti i rivlerësimit Flamur Kolleshi ka ndërruar jetë.

4. Komisioni iu drejtua me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për t'u vënë në dispozicion nga ky institucion certifikata e vdekjes për të ndjerin Flamur Kolleshi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile informoi Komisionin se Flamur Kolleshi ka ndërruar jetë në datën 14.2.2022, duke i dërguar Komisionit edhe certifikatën e vdekjes.

ARSYETIMI I KOMISIONIT

6. Subjekti i rivlerësimit Flamur Kolleshi, me funksion ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

7. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim të:

- nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sipas kësaj dispozite: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen*”, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi;
- nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “*Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen*”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 90, 93 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë

këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 165 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit Flamur Kolleshi.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana